REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË **MINISTRIA E DREJTËSISË**

www.moh.gov.al www.justice.gov.al

Nr. 2443/2 prot, datë 10.11.2011 Nr. 7352/1prot, datë 17.11.2011

UDHËZIM

Nr. 465 datë 10.11.2011

"PËR INSPEKTIMIN HIGJIENO-SANITAR NË INSTITUCIONET E EKZEKUTIMIT TË DËNIMEVE PENALE DHE TË PARABURGIMIT"

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 7, 12, 21 të ligjit nr.7643, datë 02.12.1992 "Për Shëndetin Publik dhe Inspektoratin Sanitar Shtetëror", i ndryshuar, neneve 2, 7, 9, 12, 13, 15/ç, 16, 18, 28 të ligjit nr.7761, datë 19.10.1993 "Për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse", i ndryshuar dhe të neneve 18, 23, 24, 33 të ligjit nr.8328, datë 16.04.1998 "Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim dhe të Paraburgosurve", i ndryshuar, Ministri i Shëndetësisë dhe Ministri i Drejtësisë

UDHËZOJNË :

1. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1.1 Udhëzimi është i detyrueshëm për zbatim nga Inspektorati Sanitar Shtetëror në ushtrimin e kontrolleve higjieno-sanitare në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe të paraburgimit dhe nga administrata e institucionit, si dhe Shërbimi Mjekësor pranë Drejtorive të Burgjeve.

1.2 Drejtoritë Rajonale të Shëndetësisë dhe Drejtoritë e Shëndetit Publik nëpërmjet strukturave të, Inspektoratit Sanitar Shtetëror inspektojnë të paktën dy herë në vit, institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe të paraburgimit (në vijim "institucioni"), për

kontrollin e gjendjes higjieno-sanitare të mjediseve të tyre, pajisjen e tyre me Aktmiratim Higjieno-Sanitar dhe me Libreza Shëndetësore të personelit përkatës. Inspektimet përfshijnë edhe masat e marra nga administrata dhe Shërbimi Mjekësor i institucionit, për parandalimin e luftimin e sëmundjeve infektive.

Drejtoritë Rajonale të Shëndetësisë dhe Drejtoritë e Shëndetit Publik, në inspektimet e tyre bashkëpunojnë me administratën dhe me Shërbimin Mjekësor të institucionit dhe janë të detyruar të zbatojnë kërkesat e rregullores së brendshme të institucionit.

Me kërkesë të administratës dhe Shërbimit Mjekësor të institucionit, Inspektorati Sanitar Shtetëror dhe strukturat e tjera të Shëndetit Publik (Shërbimi i Epidemiologjisë dhe i Promocionit të Shëndetit) kryejnë inspektime dhe përmbushin detyrimet ligjore në çdo kohë.

2. NDËRTESAT DHE MJEDISET E JASHTME

2.1. Ndërtesat e institucionit, mjediset e tyre, përfshirë edhe mjediset për ajrim, duhet të plotësojnë kushtet higjeno-sanitare dhe të kenë hapësirat e duhura për qëndrim dhe zhvillimin e veprimtarive të përbashkëta.

2.2. Në territorin e institucionit të parashikohen zona të gjelbëruara, që ndikojnë pozitivisht në përmirësimin e mikroklimës.

2.3. Institucioni duhet të furnizohet me ujë të pijshëm higjenikisht te paster, ndërsa ujërat e zeza, ujërat e përdorur dhe ato teknologjike, të derdhen në rrjetin përkatës të kanalizimeve.

Për largimin e ujrave të zeza mund të shfrytëzohen edhe gropat septike, të ndërtuara në përputhje me normat sanitare teknike. Gropat septike zbrazen:

- kur niveli i ujrave të zeza në to arrin në rreth 2/3 e volumit të tyre

dhe

- në periudha të përshtatshme të 24 orëshit për të mos shkaktuar pakënaqësi.

Pas zbrazjes të gropave septike, bëhet dezinfentimi i grykës, kapakut dhe territorit për-rreth me gëlqere të kloruar, apo dezinfektantë të tjerë të përshtatëshëm.

2.4. Në mjediset e jashtme të institucionit vendosen kazanët e mbeturinave të ndryshme, të cilët duhet të jenë pajisur me kapak. Kazanët dezinfektohen me gëlqere të kloruar, brenda, jashtë dhe për rreth, sa herë hiqen mbeturinat.

Kazanët e mbeturinave zbrazen të paktën një herë në 24 orë.

2.5. Sipas rasteve, në të gjithë mjediset e jashtme dhe të brendshme të institucionit, kryhet dhe dëshmohet shërbimi DDD (dezinfektim, dezinsektim, deratizim) kundër insekteve, brejtësve, dhe semundjeve te transmetueshme nepermjet vektorve.

3. MJEDISET E BRENDSHME

3.1. Mjediset e qëndrimit dhe të fjetjes (dhomat), korridoret dhe mjedise të tjerë të përbashkët.

3.1.1. Në përmbushje të kërkesave higjieno-sanitare dhomat duhet:

- të jenë të rregullta përsa i përket mureve, dyshemeve, tavaneve, dritareve, dyerve, patinimeve dhe lyerjeve
- të kenë dritare me xhama, sipas rastit edhe me perde, për të siguruar ndriçimin e nevojshëm natyror dhe ajrimin
- të sigurohet temperaturë optimale (rreth 18-20^{0}C) dhe lagështirë relative e ajrit 40-60%

3.1.2. Për çdo të dënuar të ketë një shtrat vetiak dhe një komplet të përshtatshëm fjetjeje: dyshek, jastëk, këllëfë, çarçafë, mbulesa sipas stinës.

Mjediset e qëndrimit dhe të fjetjes duhet të jenë të pajisur me:

a) komodina,
b) raft-garderobë
c) tavolinë
d) karrige,
e) lavaman me ujë të pijshëm të rrjedhshëm
f) nyje hidrosanitare
g) pajisjet dhe mjetet e nevojshme për higjienën vetjake.
h) kosh/kosha për mbeturina, të pajisur me qese plastike.

3.1.3. Një herë në javë organizohet dhe bëhet pastrimi i përgjithshëm i dhomave

3.1.4. Në nyjet hidrosanitare muret duhet të jenë të veshur me pllaka majolike deri në lartësinë rreth 1,8 m dhe mjedisi të dezinfektohet jo më pak së 3 herë në 24 orë, duke përdorur mjete të përshtatshme .

3.1.5. Institucioni siguron shërbimet e:

a) pastrimit të mjediseve
b) veshmbathjes dhe pajisjes vetjake të të dënuarve
c) të qethje, rruajtjes.

3.1.6. Mjediset e brendshme të institucionit duhet të jenë në çdo kohë të pastruar. Koshat e mbeturinave zbrazen dy herë në ditë.

3.1.7. Larja e dyshemeve, korridoreve, shkallëve dhe mjediseve të tjera të brëndshme bëhet duke përdorur dy kova (me vëllim rreth 10 litra secila), njera me solucion larës apo me solucion dezinfektant me bazë klori (hypoklorit natriumi 1-2%), apo solucion sode, dhe kova tjetër, me ujë për shpëlarjen e shtupës.

Pas përfundimit të pastrimit, shtupa shpëlahet, dezinfektohet me solucion 1-2% hypoklorit natriumietj, shtrydhet mirë dhe vendoset për tharje. Po kështu trajtohen dhe pastrohen edhe kovat për pastrim.

3.1.8. Larja e mjedisve të ekzekutimit të vendimeve penale bëhet dy herë në ditë.

3.1.9. Të gjithë shërbimet realizohen në përmbushje të kërkesave përkatëse higjieno-sanitare.

3.1.10. Punonjësit e ngarkuar me pastrimet duhet të jenë të paisur me Librezë Shëndetësore. Ata furnizohen nga institucioni me mjetet dhe lëndët e nevojshme të pastrimit.

3.1.11. Lëndët larëse dhe dezinfektuese, si dhe paisjet përkatëse (kova, shtupa) mbahen në vende të veçanta dhe pa lagështirë.

3.1.12. Kërkesat higjieno-sanitare mbi rregullshmërinë dhe pastrimin e mjediseve, zbatohen edhe për mjediset e paraburgimit.

3.2. Blloku ushqimor: kuzhina dhe anekset përkatëse; mjedisi i ngrënies

3.2.2. Ushqimi, si rregull, përgatitet, jepet dhe konsumohet në mjedise që janë të rregullt dhe disponojnë të gjitha orenditë dhe paisjet për ngrënie.

3.2.3. Ushqimi përgatitet dhe konsumohet brenda ditës.

3.2.4. Kuzhina dhe anekset e saj duhet të kenë:

- ndarjet e duhura të gatimit dhe magazinimit të produkteve ushqimore,
- paisje si frigoriferë, soba, banakë, dollapë, etazherë, lavapjata, aspiratorë, enë kuzhine dhe paisje për ngrënie, kosha për depozitimin e mbeturinave,
- anekse për larjen dhe depozitimin e enëve
- garderobë për personelin

dhe

- nyje hidrosanitare.

Ndarjet e bllokut ushqimor duhet të jenë të rregullta përsa i përket mureve, dyshemeve, tavaneve, dritareve dhe dyerve, lyerjeve, patinimeve, si dhe të jenë të furnizuara me ujë të të pijshëm, dhe me shkarkimet e rregullta të ujrave të përdorur.

3.2.5. Muret e kuzhinës dhe anekseve të jenë të veshura me pllaka majolike në lartësi rreth 1,80 m nga dyshemeja. Dritaret dhe dera e jashtme duhet të kenë rrjetë teli për të penguar hyrjen e mizave.

3.2.6. Personat që punojnë në bllokun ushqimor, për përgatitje dhe shpërndarje ushqimi, duhet të jenë të pajisur me Librezë Shëndetësore. Ata duhet të përmbushin nivelin e kërkuar

higjieno-sanitar në manipulimin e ushqimeve dhe çdo punonjës, gjatë gjithë kohës së shërbimit, të zbatojë rregullat e higjienës personale. Veshjet e punës (përparse e bardhë dhe kapuç dhe, sipas rastit, doreza, syze mbrojtëse) duhet të jenë të përshtashme, të pastra, dhe gjithnjë në përdorim gjatë shërbimit.

Uniforma e personelit jashtë shërbimit, mbahet në rafte të veçantë.

3.2.7. Gjatë dërgimit të ushqimit nga kuzhina tek të dënuarit, shpërndarja duhet të plotësojë kërkesat higjienike, duke shmangur mundësitë e ndotjes. Ushqimi nuk duhet të shpërndahet me enë të zbuluara, të dëmtuara, ose të papastra. Gjatë shpërndarjes së ushqimit, personat përgjegjës këshillohet të përdorin doreza dhe, sipas rastit, mbulesë të gojës dhe hundëve.

3.2.8. Konsumimi i ushqimit bëhet në mjedisin e ngrënies, që përmbush kërkesat higjieno-sanitare përsa i përket përmasave, mirëmbajtjes, paisjeve, shërbimit dhe anekseve, përfshirë edhe ato hidrosanitare.

3.2.9. Mjediset e bllokut ushqimor duhet të jenë në çdo kohë të pastruara.

3.2.10. Enët e palara nuk lejohet të kalojnë nëpërmjet mjedisit të gatimit.

3.2.11. Mostrat ushqimore të gatimeve mbahen 24 orë nga koha e gatimit. Ato ruhen në vende të freskëta, në një dollap me ndarje të mbyllur me çelës dhe janë në çdo rast në dispozicion të administratës dhe shërbimit mjekësor të institucionit, si dhe të Inspektoratit Sanitar Shtetëror gjatë inspektimeve të ushtruara.

3.2.12. Inspektimi higjieno-sanitar i produkteve ushqimore përfshin kontrollin e kushteve të magazinimit, përpunimit dhe shpërndarjes së tyre, si dhe gjendjen fizike të ushqimeve, ambalazhimin, etiketimin, datën e prodhimit dhe të përdorimit dhe dokumentacionin shoqërues.

3.2.13. Administrata e institucionit pranon ushqime tërësisht ose pjesërisht për të dënuarit, ose që i siguron ato me shpenzimet e tij, duke respektuar kërkesat e rregullores së brendshme të institucionit dhe përmbushjen e kërkesave higjieno-sanitare.

Në raste të veçanta, të dënuarit, duke përmbushur kërkesat higjieno-sanitare dhe të rregullores së brendëshme të institucionit, mund të përgatisin dhe të konsumojnë ushqimin individualisht.

3.2.14. Të dënuarve duhet t'u sigurohet ujë i pijshëm i mjaftueshëm dhe higjienikisht i pastër sipas përcaktimeve dhe kërkesave të "Rregullore higjeno-sanitare për kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm, projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mbikqyrjen

e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm", miratuar me Vendim nr.145, datë 26.02.1998 të Këshillit të Ministrave. Edhe për furnizimi me ujë nëpërmjet depozitave, apo nga puset dhe burime uji, zbatohen kërkesat e kësaj rregulloreje, si dhe rekomandimet përkatëse të Ministrisë së Shëndetësisë për pastrimin dhe dezinfektimin e puseve dhe depozitave të ujit të pijshëm për sigurimin e ujit higjienikisht të pastër.

3.2.15. Kontrollli i cilësisë së ujit të pijshëm realizohet nga Inspektorati Sanitar Shtetëror në zbatim të "Rregullore higjeno-sanitare për kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm, projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mbikqyrjen e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm", me bashkëpunimin e administratës së institucionit.

3.2.16. Përveç kontrolleve periodike të ujit të pijshëm nga Inspektorati Sanitar Shtetëror, shërbimi mjekësor i institucionit, sipas udhëzimeve të Inspektoratit Sanitar Shtetëror dhe në bashkërendim, merr mostra uji të pijshëm dhe kryen, pa pagesë, analiza fiziko-kimike & mikrobiologjike në Drejtorinë Rajonale të Shëndetësisë, apo Drejtorinë e Shëndetit Publik.

3.3. Lavanderia

3.3.1. Trajtimi i rrobave te veshjes individuale dhe te fjetjes bëhet sipas rregullores së institucionit. Grumbullimi i teshave të palara, futur në thasë/ qese plastike, apo thasë beze të gomuar, bëhet në vende të caktuara.

3.3.2. Teshat e palara të grumbulluara dërgohen në lavanderi brenda ditës.

3.3.3. Lavanderia e institucionit duhet të ketë mjedise/ndarje dhe shërbime për:

a) pranimin e teshave
b) larjen
c) riparimin e teshave
d) hekurosjen
e) magazinimin e teshave
f) dorëzimin e teshave

3.3.4. Në proçesin e larjes dhe të trajtimit të teshave, zbatohen rregullat higjieno-sanitare për lavanderitë.

3.3.5. Teshat e lara dorëzohen nga lavanderia të ambalazhuara në qese plastike.

3.3.6. Punonjësit e lavanderisë dhe të trajtimit të rrobave duhet të jenë paisur me Librezë Shëndetësore.

4. SHËRBIMI MJEKËSOR

4.1. Pranimi i të dënuarve në institucion

4.1.1. Me pranimin në institucion, i dënuari i nënshtrohet:

a) një vizitë mjekësore të përgjithshme dhe analizave përkatëse për përcaktimin e gjendjes shëndetësore

b) vlerësim i parametrave të përgjithshëm jetësorë

c) inspektim dhe vlerësim për gjendje febrile apo subfebrile, shfaqje patologjike në lekurë apo mukoza, shfaqje hemoragjike, kompromentim të frymëmarrjes, gjendja e abdomenit, simptoma gastro-intestinale, shfaqje të prekjes së meningjeve, higjiena personale, gjendja mendore.

4.1.2. Të gjithë personat që hyjnë rishtas në institucionet e ekzekutimit të dënimeve penale duhet të kontrollohen për sëmundje që dëmtojnë shëndetin e tyre dhe të personave të tjerë të dënuar, apo punonjës të administratës.

4.1.3. Të dënuarit rishtas, përpara se të futen në dhomat e tyre, duhet të lahen në dush.

4.1.4. Çdo të dënuari i sigurohet veshmbathje dhe pajisje të tjera individuale, në sasi të mjaftueshme, në gjendje të mirë dhe të pastra, për sigurimin e kërkesave normale të jetesës.

4.1.5. Shërbimi Mjekësor i institucionit, me kërkesë të Inspektoratit Sanitar Shtetëror, apo të Shërbimit të Epidemiologjisë, vë në dispozicion dokumentacionin që disponon lidhur me kryerjen e kontrollit për gjendjen shëndetësore të të dënuarve.

4.2. Shërbimi mjekësor dhe edukimi shëndetësor i të dënuarve

4.2.1. Organizimi i shërbimit mjekësor bëhen nga administrata e institucionit, në bashkëpunim me shërbimin mjekësor të institucionit dhe shërbimin shëndetësor në spitalin e burgjeve. Në raste të veçanta me kërkesë nga vetë institucioni ,mund të thërriten edhe përfaqësues të Drejtorive të Shëndetit Publik, (Inspektorati Sanitar Shtetëror dhe Shërbimi i Epidemiologjisë).

4.2.2. Shërbimi Mjekësor i institucionit ka për detyrë:

a) të marrë masa për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse.

b) të informojë rregullisht shërbimin e Higjienës dhe Epidemiologjisë në Drejtorinë Rajonale të e Shëndetit Publik/ Drejtorinë e Shëndetit Publik për rastet e sëmundjeve ngjitëse, masat parandaluese të ndërmarra, zbatimin e kalendarit të vaksinimit dhe mbulesën vaksinore tët të dënuarëve.

4.2.3. Në rast shfaqjeje të sëmundjeve ngjitëse dhe/ose të ndonjë shpërthimi të mundshëm epidemik epidemiologët, ndihmësepidemiologët dhe punonjësit e tjerë të strukturave të Drejtorive të Shëndetit Publik, të ngarkuar për zbatimin e masave parandaluese dhe të rregullores së brendëshme të

institucionit, kanë të drejtë të hyjnë në institucionet e ekzekutimit të dënimeve penale dhe të paraburgimit, të mbështetur nga shërbimin mjekësor i institucionit, për të bërë hetimin epidemiologjik të rastit ,izolimin e shkaktarit, dezinfektimin e ambienteve dhe marrjen e masa të tjera për normalizimin e situatës.

4.2.4. Për rastet e sëmundjeve ngjitëse ose të sëmundjeve të tjera, diagnostikimi dhe mjekimi i të cilave nuk mund të sigurohen në kushtet e institucionit, të dënuarit, në përputhje me rregullat në fuqi, transferohen në spitalin e burgjeve, apo në institucionet spitalore, në rang qarku apo rrethi.

4.2.5. Institucionet e ekzekutimit të dënimeve penale duhet të kenë mjedise të posaçme, ku të sistemohen të dënuarit, që dyshohen ose kanë sëmundje ngjitëse dhe që përbëjnë rrezik transmetimi tek të dënuarit e tjere, apo personeli i institucionit.

Mjedisi i posaçëm përbëhet nga një mjedis i veçantë izolimi me ndarjet, paisjet dhe orenditë e duhura dhe përmbush kërkesat higjieno-sanitare.

4.2.6. Drejtuesit e institucioneve të ekzekutimit të dënimeve penale dhe vartësit e tyre janë të detyruar të zbatojnë detyrat e lëna nga epidemiologët dhe ndihmësepidemiologët, kur në mjedisin e objekteve të mësipërm është shfaqur qoftë edhe një rast me sëmundje ngjitëse.

4.2.8. Shërbimi Mjekësor i institucionit, që ka bërë denoncimin dhe mjekimin e të sëmurëve me sëmundje ngjitëse, është i detyruar të njoftojë edhe për përfundimin e sëmundjes.

4.2.9. Për parandalimin dhe luftimin e AIDS (SIDA), zbatohen kërkesat e ligjit nr.9952, datë 14.07.2008 "Për parandalimin dhe kontrollin e HIV-AIDS" dhe të Vendimit nr.113, datë 17.02.2011 i Këshillit të Ministrave "Për parandalimin e transmetimit te HIV/AIDS dhe për kujdesin, këshillimin dhe trajtimin e personave që jetojnë me HIV/AIDS në institucionet e arsimit, të riedukimit, institucionet e trajtimit mjekësor, institucionet rezidenciale, të përkujdesit social, burgjet dhe vendet e paraburgimit".

4.2.10. Në institucionet ku vuajnë dënimin gratë, funksionojnë shërbimet speciale në shërbim të grave shtatzëna dhe të atyre me fëmijë në gji.

4.2.11. Shërbimi Mjekësor i institucionit duhet të garantojë sigurimin e higjienës së mjedisit në përgjithësi dhe në të gjithë mjediset e veçanta në përdorim dhe shfrytëzim nga të dënuarit, apo të paraburgosurit.

4.2.13. Për edukimin sanitar të të dënuarve, në mbështetje të inspektorëve sanitarë shtetërorë dhe në bashkëpunim me administratën dhe shërbimin mjekësor të institucionit, sipas

problematikave të hasura dhe "Kalendarit vjetor të Promocionit të Shëndetit" të përditësuar, në inspektimet higjieno-sanitare periodikisht mund të jenë të pranishëm edhe punonjësit e Promocionit të Drejtorive Rajonale të Shëndetësisë/Drejtorive të Shëndetit Publik.

4.3. Pajisja me Aktmiratim Higjieno-Sanitar dhe Libreza Shëndetësore

Në zbatim të ligjit nr.7643, datë 02.12.1992 "Për Shëndetin Publik dhe Inspektoratin Sanitar Shtetëror", i ndryshuar (neneve 12 dhe 21), Udhëzimit nr.139, datë 14.04.2011 "Për lëshimin e Aktmiratimit Higjieno-Sanitare" dhe Rregullores "Për kontrollin mjekësor dhe lëshimin e Librezave Shëndetësore" të Ministrisë së Shëndetësisë, Inspektorati Sanitar Shtetëror, me përmbushjen e kërkesave përkatëse, pajisë me Aktmiratim Higjieno-Sanitar institucionet e ekzekutimit të dënimeve penale dhe të paraburgimit, si dhe me Libreza Shëndetësore punonjësit e administratës së institucionit. Librezat Shëndetësore rinovohen çdo vit dhe disponohen individualisht në çdo kohë në vendin e punës.

Bartësit e sëmundjeve të caktuara, si tifos abdominale, të dizanterisë dhe persona me sëmundje të lëkurës, duarve, fytyrës, nuk pajisen me Librezë Shëndetësore dhe nuk lejohet të kryejnë shërbime në institucionet e ekzekutimit të dënimeve penale dhe të paraburgimit, për të cilat kërkohet Libreza Shëndetësore.

Administrata dhe shërbimi mjekësor i institucionit bashkëpunon me Inspektoratin Sanitar Shtetëror në pajisjen e institucionit me Aktmiratim Higjieno-Sanitar dhe të punonjësve përkatës me Libreza Shëndetësore, duke respektuar afatet kohore per rinovimin e tyre.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

PETRIT VASILI	**EDUARD HALIMI**
MINISTËR I SHËNDETËSISË	**MINISTËR I DREJTËSISË**